




Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural
Ministarstvo Poljoprivrede, Šumarstva i Ruralnog Razvoja
Ministry of Agriculture, Forestry and Rural Development
Kabineti i Ministrit / Kabinet Ministra / Cabinet of the Minister



Datë: 29.11.2023
Ref. KM-407/23

Në mbështetje të nenit 145 (paragrafi 2) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke marrë parasysh nenet 8, 9, 10, 11, 22 dhe 23 të Ligjit Nr. 06/L-113 për Organizimin dhe Funksionimin e Administratës Shtetërore dhe të Agjencive të Pavarura, (Gazeta Zyrtare, Nr. 7/ 01 mars 2019), duke u bazuar në nenin 4 paragrafi 1 nën paragrafi 1.11. Shtojcën 1: pika 11 të Rregullores (QRK)-NR.14/2023 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive (16.08.2023), Ministri i Ministrisë së Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, nxjerrë:

V E N D I M

- Z. Fidan DEMA**, në pozitën e Zëvendësuesit të Drejtorit Ekzekutiv të Agjencisë Pyjore të Kosovës, caktohet në pozitën Ushtruesi i detyrës së Drejtorit Ekzekutiv të Agjencisë Pyjore të Kosovës në Ministrinë e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural.
- I caktuari, detyrën - Ushtruesi i detyrës së Drejtorit Ekzekutiv i Agjencisë Pyjore të Kosovës në Ministrinë e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, e ushtron nga data 01 Dhjetor 2023 me të gjitha të drejtat dhe detyrat e përcaktuara në nenin 35 paragrafi 3 dhe 4 të Ligjit Nr. 08/L-197 për Zyrarët Publik (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.21/18 Shtator 2023) dhe legjislacionin përkatës në fuqi.
- I caktuari nga pika 1 dhe 2 të këtij vendimi do të kompensohet sipas legjislacionit në fuqi.
- Me hyrjen në fuqi të këtij Vendimi shfuqizohet Vendimi me Ref.KM-124/23 të datës 03.04.2023, të protokolluar me Nr.1346 të datës 03.04.2023.
- Zyrtari publik nuk mund të caktohet si ushtrues detyre më gjatë se gjashtë (6) muaj. Kur pozita nuk mund të plotësohet brenda afatit gjashtë (6) mujor, ky afat mund të zgjas më së shumti edhe për gjashtë (6) muaj të tjerë.
- Obligohet Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural – Divizioni për Burime Njerëzore dhe të gjitha Njësitë tjera organizative për zbatimin e këtij vendimi.
- Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Ministër i Ministrisë së Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural

Faton Peci

Vendimi i dërgohet:

- *Fidan Dema,*
- *Kabinetit të Ministrit,*
- *Zyrës së Sekretarit të Përgjithshëm,*
- *Agjencia Pyjore të Kosovës, dhe*
- *Arkivit.*

